

Analiza e Qeverisjes së Hapur të Ministrisë së Arsimit,
Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (2023)

Propozime për përmirësimin e gjendjes aktuale

ANALIZA E QEVERISJES SË HAPUR TË MINISTRISË SË ARSIMIT, SHKENCËS, TEKNOLOGJISË DHE INOVACIONIT

RRETH PUBLIKIMIT

Ky dokument u zhvillua si pjesë e projektit ‘**Përmirësimi i Qeverisjes së Mirë 5.0&6.0**’, i mbështetur nga **National Endowment for Democracy (NED)**, dhe i implementuar nga **Open Data Kosovo (ODK)**.

AUTORËT

Dafina Olluri dhe Anita Selita

VERSIONET GJUHËSORE

SHQ, ANG, SER

Përfunduar në PRILL, 2025 © ODK

Pikëpamjet e shprehura në këtë dokument janë përgjegjësi vetëm e autorëve dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht qëndrimin zyrtar të NED. Riprodhimi dhe përkthimi për qëllime jofitimprurëse janë të autorizuara, me kusht që të dihet burimi dhe publikuesi të njoftohet paraprakisht dhe të dërgohet një kopje.

ANALIZA E QEVERISJES SË HAPUR TË MINISTRI SË SË ARSIMIT, SHKENCËS, TEKNOLOGJISË DHE INOVACIONIT

PËRMBAJTJA

Hyrje	1
Metodologjia e Hulumtimit	2
QASJA	2
NDËRGJEGJSIMI	3
INTEGRITETI	4
TRANSPARENCA	5
ANGAZHIMI I QYTETARËVE NË AKTIVITETET E KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS	6
REKOMANDIMET	7

HYRJE

Hapja e të dhënave është një proces i rëndësishëm në vendimmarrje dhe në krijimin e lidhjeve mes qytetarëve dhe institucioneve. Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI), si institucion, ndihmon që, përmes hapjes së të dhënave, të përmirësohet cilësia dhe transparenca në sistemin arsimor. MASHTI kontribuon vazhdimisht në publikimin e të dhënave mbi performancën e shkollave, regjistrimin e studentëve, infrastrukturën arsimore dhe rezultatet e nxënësve, duke ndihmuar qytetarët dhe institucionet të kuptojnë më mirë sfidat dhe nevojat kryesore të sistemit arsimor. Kjo mundëson ndërmarrjen e hapave konkretë për t'i adresuar problemet brenda këtij institucioni.

Hapja e të dhënave për Kosovën është një hap përpara për ti adresuar sfidat e transparencës dhe përgjegjshmërisë institucionale. Kjo qasje e të dhënave në mënyrë të thjesht dhe të kuptueshme për qytetarët, jo vetëm nga MASHTI, por edhe nga institucionet e tjera shtetërore, ndihmon jo vetëm në informimin e qytetarëve dhe angazhimin e të rinjve, por edhe në llogaridhënien, duke u krijuar atyre mundësinë të shprehin mendimet dhe sugjerimet e tyre në procesin e vendimmarrjes. Këto të dhëna u mundësojnë qytetarëve të vlerësojnë nëse rregulloret dhe politikat po zbatohen siç duhet dhe të ndihmojnë në përmirësimin e tyre aty ku është e nevojshme.

Qeveria e Kosovës po punon për të hapur të dhënat dhe për të rritur transparencën, në krye me Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI). Përpjekjet e tyre janë pjesë e angazhimit për t'u bashkuar me nismën Open Government Partnership (OGP), me synimin për të përmbushur standardet ndërkombëtare dhe për të inkurajuar pjesëmarrjen aktive të qytetarëve. Kosova ka bërë hapa të rëndësishëm drejt transparencës dhe qeverisjes së hapur. Përpjekjet për ta përfshirë Kuvendin në nismat globale si OGP dhe krijimi i platformave bashkëpunuese, si Forumi për Transparencë Parlamentare, janë dëshmi e angazhimit për të forcuar lidhjen mes qytetarëve dhe institucioneve. Këto iniciativa synojnë rritjen e pjesëmarrjes qytetare.

Përmes këtij punimi ne planifikojmë të analizojmë nivelin e hapjes dhe transparencës në Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI) për vitin 2023, duke përdorur të dhënat e Indeksit të Hapjes. Ky punim ka për qëllim të ofrojë një menyrë të qartë rreth hapjes së të dhënave në këtë ministri, të identifikojë sfidat që hasen dhe të sugjerojë hapa për përmirësimin e qeverisjes së hapur. Përmes këtij hulumtimi, dëshirojmë të kontribuohet në përmirësimin e transparencës dhe të llogaridhënjes.

METODOLOGJIA E HULUMTIMIT

Ky hulumtim bazohet në të dhënat përfundimtare të vitit 2023 nga Indeksi Rajonal Institucional, i cili analizon nivelin e transparencës dhe qasjes në informacion të komunave dhe ministrive në Kosovë. Raporti fokusohet në aspekte kryesore si publikimi i dokumenteve buxhetore, transparenca financiare dhe mundësia që qytetarët të kenë qasje në dokumente dhe informacione të tjera relevante.

Studimi permban të dhënat e mbledhura nga raportet e indeksit, pyetësorët e zhvilluar me Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI), dhe dokumentet e ofruara nga kjo ministri. Ne kete punim janë vlerësuar katër parime themelore: transparenca, qasja në informacion, integriteti institucional dhe ndërgjegjësimi i qytetarëve. Ky vlerësim është realizuar duke analizuar keto kritere si, sa ka qene e lehte per qytetaret qasja ne dokumentet zyrtare permes faqes se internetit, cilësia e rregullimeve ligjore për transparencën, burimet shitesë të informacionit publik të ofruara nga institucioni dhe përgjigjet ndaj pyetësorëve.

Hulumtimi është përqendruar vetëm në periudhën e vitit 2023, duke marrë në konsideratë progresin në aspektin e transparencës që nga viti 2023, kur ishte zhvilluar raport paraprak nga NED 3.0 dhe 4.0. Krahassimi i të dhënave mes këtyre dy viteve ndihmon në identifikimin e arritjeve dhe sfidave të mbetura, ndërsa rekomandimet e ofruara janë bazuar në analizat e fundit të bëra.

QASJA

Parimi i qasjes, si pjesë thelbësore i MASHT-it synon të ndërtojë një lidhje më të afërt dhe gjithëpërfshirëse midis MASHTI-it dhe qytetarëve, duke përfshirë të gjitha palët e interesit. Sipas këtij parimi dokumentet zyrtare duhet të jenë të qasëshme dhe të lehta për t'u gjetur dhe lexuar nga qytetarët. Një nga qëllimet kryesore është që qytetarët të jenë jo vetëm të informuar, por edhe të kenë mundësinë të japin mendime dhe sugjerime mbi politikën dhe programet arsimore, duke ndihmuar MASHTI'n të perputhet me nevojat dhe pritshmerite të tyre.

Gjatë vitit 2023-2024, MASHTI ka shënuar progres në drejtim të transparencës dhe llogaridhënjes, duke rritur qasjen në informacion dhe duke krijuar mundësi për një dialog më të hapur me qytetarët dhe grupet e interesit. Kjo dhe tregohet me zvoglimin e kërkesave nga MASHT për qasje në dokumente që nga viti 2023 . Në baze të kërkesave për qasje në dokumente ranë nga 55 në vitin 2022 në 33 në vitin 2023, duke reflektuar përmirësimin e transparencës dhe rritjen e qasjes në informacion që nga viti 2022.

Po ashtu MASHTI per vitin 2023-2024 ka shënuar nje arritje ne transparence prej 70%. Në anën tjetër, publikimi i planeve strategjike dhe dokumenteve të tjera, si Strategjia e Arsimit 2022-2026, ka shërbyer jo vetëm si një platformë në mënyrë që qytetarët të kontribuojnë me rekomandimet e tyre po edhe ka treguar përparimet në llogaridhënie. MASHTI ka bërë në fushën e transparences pasi që në uebfaqen e tyre MASHT e ka një kanal të veçantë të komunikimit në mënyrë që qytetarët të drejtojnë kërkesat dhe ankesat e tyre drejtperdrejt MASHT-it. Gjithashtu, MASHTI është duke punuar në hartimin e strategjisë për informim dhe komunikim për vitin 2025.

Në anën tjetër, Ligji për Qasje në Dokumente Publike (Nr. 06/L-081) ka qenë i rëndësishëm për këto përpjekje, duke detyruar të gjitha institucionet publike të publikojnë çdo dokument zyrtar. Ky ligj ka përmirësuar transparencën dhe llogaridhënien, duke krijuar një mjedis ku qytetarët kanë më shumë besim dhe mundësi për përfshirje aktive. Në këtë drejtim, MASHTI ka investuar në trajnime për stafin dhe në përmirësimin e platformave digjitale për të bërë qasjen më të lehtë dhe më të shpejtë. Megjithatë, një nga sfidat kryesore për MASHT-in mbetet fakti që shkollat nuk kanë kode buxhetore të pavarura, pasi menaxhimi financiar kryhet nga komunat. Ky sistem i kufizon shkollat në publikimin e shpenzimeve të tyre, gjë që e vështirëson arritjen e një transparence të plotë në nivelin e institucioneve arsimore lokale.

NDËRGJEGJËSIMI

Në vitin 2023, Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI) e Kosovës ka ndërmarrë hapa të rëndësishëm për të rritur ndërgjegjësimin në fushën e arsimit, duke theksuar rëndësinë e mirëqenies së nxënësve dhe mbrojtjes së mjedisit. Në shtator 2023, MASHTI nënshkroi një Memorandum Mirëkuptimi me organizatat joqeveritare Vier Pfoten Kosova dhe Fondacionin për të Drejtat e Kafshëve, me qëllim promovimin e edukimit për mirëqenien e kafshëve dhe mbrojtjen e mjedisit në shkolla dhe aktivitete jashtëshkollore. Ky bashkëpunim synon të ndërgjegjësojë brezat e rinj për rëndësinë e ruajtjes së mjedisit dhe trajtimit të duhur të kafshëve, duke përfshirë edhe çështjen e qenve endacakë ([MASHT](#)).

Në të njëjtin muaj, MASHTI bashkëpunoi me Qendrën Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës (QKRMT) për të përmirësuar shërbimet e shëndetit mendor për nxënësit në Prishtinë dhe Gjilan. Projekti "Mendje për Paqe" synon të rrisë kapacitetet e psikologëve shkollorë dhe të ofrojë mbështetje për rreth 250 nxënës, duke theksuar rëndësinë e qasjes së informuar ndaj traumës në mjedisin shkollor ([MASHT](#)).

Këto iniciativa pasqyrojnë përkushtimin e MASHTI-t për të integruar ndërgjegjësimin në politikat arsimore, duke promovuar një mjedis edukativ që vlerëson mirëqenien e nxënësve dhe përgjegjësinë ndaj mjedisit.

INTEGRITETI

Në vitin 2022, Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI) kishte një rezultat të integritetit prej 65%. Krahësuar me vitin e kaluar, në vitin 2023 janë vërejtur disa përmirësime dhe masa të reja të ndërmarra nga institucioni. Një prej ndryshimeve më domethënëse ka qenë hartimi dhe publikimi i një kodi të mirësjelljes për zyrtarët e saj në uebfaqen zyrtare, i cili përcakton qartë sjelljet e pritura për liderët e zgjedhur, stafin politik dhe nëpunësit publikë. Ky hap ka ndihmuar në adresimin e mungesës së një rregulloreje të tillë që u evidentua në raportin e vitit 2023 dhe ka rezultuar në ngritje të përgjithshme prej 67%.

MASHTI gjithashtu ka forcuar procesin e deklarimit të pasurisë, duke siguruar që deklaratat e zyrtarëve të jenë më të aksesueshme për publikun, në përputhje me Ligjin për Qasje në Dokumente Publike dhe Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Kjo ka rritur transparencën dhe llogaridhënien e zyrtarëve të institucionit. Një tjetër zhvillim i rëndësishëm ka qenë ofrimi i trajnimeve për zyrtarët mbi temat që lidhen me aktivitetet e lobimit, konfliktet e interesit, përpjekjet kundër korrupsionit dhe sinjalizimin. Përmes këtyre trajnimeve, MASHTI ka synuar të rrisë ndërgjegjësimin dhe aftësitë e stafit të tij për të reaguar në mënyrë efektive ndaj parregullsive dhe për të mbajtur standarde më të larta etike.

Në aspektin e rregullimit të lobimit, pavarësisht se Kosovës ende i mungon një ligj specifik që rregullon këtë aktivitet, MASHTI ka ndërmarrë hapa për të promovuar transparencën në ndërveprimet me grupet e interesit, duke forcuar kështu mbrojtjen e interesit publik. Këto masa kanë ndikuar drejtpërdrejt në përmirësimin e integritetit të institucionit.

TRANSPARENCA

Që nga viti 2023, MASHTI ka ndërmarrë hapa të rëndësishëm për të përmirësuar transparencën keto hapa përfshijnë publikimin e dokumenteve strategjike dhe informacioneve kyçe, organizimin e konsultimeve publike, dhe forcimin e mekanizmave të monitorimit dhe llogaridhënies. Masat e ndërmarra kanë kontribuar në një përmirësim të dukshëm të transparencës, duke arritur një nivel transparence prej 62%, që pasqyron përkushtimin e ministrisë për të ofruar një qasje më të hapur dhe të qartë ndaj publikut.

Për më tepër, MASHTI ka vazhduar përpjekjet për të siguruar që informacionet lidhur me buxhetin, prokurimin publik, dhe dokumentet e tjera të jetë të qasshëme dhe të disponueshme për publikun përmes faqes së saj zyrtare të internetit. Faqja është përditësuar rregullisht me raporte dhe dokumente strategjike, duke siguruar akses në informacion në të dyja gjuhët zyrtare dhe promovuar angazhimin me palët e interesuara. Megjithatë, mbetet ende hapësirë për përmirësim në transparencën e kontratave dhe procedurave të prokurimit, që paraqet një fushë me mundësi zhvillimi. Këto përpjekje theksojnë angazhimin e MASHTI-t për të forcuar transparencën dhe për të mundësuar përfshirjen aktive të qytetarëve në proceset e vendimmarrjes.

Gjithashtu, prezantimi i Platformës Pivot-RP dhe dy raporteve për Transparencën Financiare dhe Profilet e Universiteteve Publike është një tjetër hap i rëndësishëm drejt forcimit të transparencës në sektorin e arsimit të lartë. Këto iniciativa janë një vazhdim i përpjekjeve për të siguruar qasje më të hapur dhe të disponueshme për informacionin e rëndësishëm publik, duke i mundësuar qytetarëve dhe palëve të interesuara të kenë një pasqyrë të qartë të funksionimit të universiteteve dhe financave publike.

ANGAZHIMI I QYTETARËVE NË PUNËN E MASHTI SË NË KOSOVË

Në vitin 2023, ODK ka vazhduar bashkëpunimin me UBO Consulting për të kryer një studim të gjithëpërfshirës mbi perceptimet e qytetarëve dhe përfshirjen e tyre në punën e MASHTI-t. Ky studim ka përfshirë një përfaqësues të gjerë prej 1132 qytetarësh nga profile të ndryshme demografike, duke analizuar faktorë si mosha, gjinia, përkatësia etnike, vendbanimi dhe të ardhurat familjare. Synimi kryesor i këtij hulumtimi ishte të vlerësohej mënyra se si qytetarët e perceptojnë qasjen e MASHTI-t ndaj shqetësimeve të tyre dhe aftësinë e tyre për të ndikuar në politikat arsimore.

Gjetjet e këtij viti tregojnë se një pjesë e madhe e qytetarëve ende ndihen të kufizuar në aftësinë e tyre për të kontribuar në proceset e MASHTI-t. Vetëm 29.9% e të anketuarve besojnë se mund të kenë një ndikim pozitiv, ndërsa shumica shprehin skepticizëm mbi përfshirjen e tyre. Për sa i përket kënaqshmërisë me performancën e MASHTI-t, 36.6% e qytetarëve janë mesatarisht të kënaqur, ndërsa vetëm 2.8% e tyre shprehen shumë të kënaqur me punën e institucionit.

Këto rezultate nënvizojnë nevojën për MASHTI-n që të forcojë përfshirjen e qytetarëve në politikat dhe vendimmarrjen e tij. Rritja e transparencës dhe krijimi i mundësive konkrete për pjesëmarrje aktive janë thelbësore për të nxitur ndjenjën e pronësisë dhe llogaridhënies në publik. Përfshirja më e madhe e qytetarëve do të ndihmonte në formësimin e politikave më të informuara dhe gjithëpërfshirëse, duke ndërtuar besimin në institucion dhe rritur efektivitetin e tij. Prandaj, MASHTI duhet të vazhdojë të zhvillojë kanale më efikase të komunikimit dhe angazhimit publik për të siguruar që iniciativat e tij të reflektojnë nevojat dhe pritshmëritë e qytetarëve të Kosovës.

REKOMANDIMET

HAPAT E VEPRIMIT

Për të ndërtuar më shumë besim, llogaridhënie dhe transparencë, Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI) mund të ndërmarrë këto hapa:

Forcimi i Llogaridhënies

Një kulturë e fortë e llogaridhënies ndihmon që qeverisja të jetë transparente dhe e ndershme. MASHTI mund ta forcojë këtë duke e publikuar Kodin e Sjelljes për zyrtarët në faqen e saj zyrtare, në mënyrë që qytetarët të dinë çfarë standardesh etike kërkojnë. Po ashtu, udhëzime të qarta për të gjithë zyrtarët – nga udhëheqësit tek nëpunësit civilë – do të ndihmonin në krijimin e një kulture të përgjegjshme.

Forcimi i Integritetit

MASHTI mund të hartojë një plan të brendshëm për integritetin ose një politikë kundër korrupsionit, për të ndihmuar në parandalimin e shkeljeve dhe për të përforcuar llogaridhënien. Trajnime të rregullta për zyrtarët mbi etikën, konfliktin e interesit dhe transparencën do të ndihmonin që të gjithë të jenë më të vetëdijshëm dhe të përgatitur për të vepruar drejt.

Rritja e Transparencës

Për të fituar më shumë besim, MASHTI duhet të bëjë publike dokumentet kryesore, projektligjet dhe rezultatet e konsultimeve, në formate të lehta për t'u lexuar dhe përdorur. Kjo do t'i ndihmonte qytetarët dhe organizatat të kuptojnë më mirë çfarë po ndodh dhe si mund të përfshihen.

Transparencë në Lobim

MASHTI mund të vendosë rregulla të qarta për aktivitetet e lobimit, për të shmangur ndikimet e padrejta në politikat publike. Një regjistër publik për lobistët do të ishte një hap i rëndësishëm për t'u treguar qytetarëve kush dhe si po ndikon në vendimmarrje.

Pjesëmarrje më e Madhe e Qytetarëve

Vetëm 33.9% e qytetarëve ndihen se mund të kontribuojnë në punën e MASHTI-t. Për ta përmirësuar këtë, Ministria mund të krijojë platforma të hapura ku qytetarët dhe organizatat mund të japin mendimet dhe sugjerimet e tyre. Kjo do të ndihmonte që më shumë zëra të përfshihen në politikat publike.

REKOMANDIMET

Ndërtimi i Besimit me Punë të Vazhdueshme

Besimi ndërtohet me kohë dhe punë të pandërprerë. MASHTI mund të kryejë vlerësime të rregullta të punës së vet dhe të kërkojë vlerësime të pavarura për të parë ku mund të përmirësohet. Hapja dhe komunikimi i drejtpërdrejtë me qytetarët do të ndihmonin shumë për ta bërë MASHTI-n një institucion më të besuar dhe më të respektuar.

RAPORTE TË TJERA TË NGJASHME

RAPORTE TË TJERA

Eksploroni raporte dhe dokumente shtesë të ngjashme me këtë raport të disponueshme në faqen e publikimeve të Open Data Kosovo.

WWW.OPENDATAKOSOVO.ORG/PUBLICATIONS

Nëse keni pyetje shtesë, mos ngurroni të kontaktoni:

info@opendatakosovo.org